

VENDIM
Nr.305, datë 16.4.2020

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE TË MASËS SË PËRFITIMIT TË NDIHMËS FINANCIARE PËR TË PUNËSUARIT AKTUALE DHE PUNONJËSIT E LARGUAR NGA PUNA SI PASOJË E COVID-19

(Ndryshuar me VKM nr. 341, datë 23.4.2020, nr. 423, datë 28.5.2020)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, dhe të pikës 5, të nenit 41, të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Dhënie ndihme financiare prej 40 000 (dyzet mijë) lekësh për të punësuarit në subjektet me të ardhura vjetore mbi 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, që kanë mbyllur aktivitetet sipas urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët kanë qenë në punë në datën e hyrjes në fuqi të këtyre urdhrave.

2. *Dhënie ndihme financiare, prej 40 000 (dyzet mijë) lekësh, për ish-të punësuarit në subjektet që janë lejuar të kryejnë aktivitetet ose janë mbyllur sipas urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët janë larguar nga puna nga data 1 mars 2020 deri në datën 17 maj 2020.*

3. Dhënie ndihme financiare prej 40 000 (dyzet mijë) lekësh për të punësuarit në subjektet me të ardhura vjetore deri në 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, që janë lejuar të kryejnë aktivitetet sipas urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët kanë qenë në punë deri në datën e hyrjes në fuqi të urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

4. Nuk e përfitojnë ndihmën sipas pikës 3, të këtij kreu, punonjësit:

a) të cilët kanë përfitur sipas pikës 2, të këtij kreu.

b) të punësuar në subjektet:

i. me objekt veprimtarie tregtim të produkteve ushqimore, fruta – perime, farmaceutike, sipas përcaktimit në urdhrat e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

ii. e regjistruara që ushtrojnë aktivitet në profesione të tilla si: avokat, noter, mjek i specializuar, farmacist, infermier, veteriner, arkitekt, inxhinier, mjek-laborant, projektues, ekonomist, agronom, ekspert kontabël i regjistruar, kontabilist i miratuar dhe vlerësues i pasurisë, që lejohen të kryejnë aktivitetin sipas urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

5. Dhënie ndihme financiare prej 40 000 (dyzet mijë) lekësh për punonjësit e subjekteve, persona fizikë ose juridikë, që ushtrojnë aktivitetin si struktura akomoduese, të cilët figurojnë në listëpagesa deri në datën e urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

6. Nëse subjekti i përmendur në pikën 5, të këtij kreu, ushtron disa lloje aktivitetesh, e përfitojnë ndihmën financiare vetëm të punësuarit në aktivitetin e strukturës akomoduese.

7. *Dhënie ndihme financiare prej 40 000 (dyzet mijë) lekësh për punonjësit e Rafinerisë së Naftës, Ballsh, të cilët figurojnë në listëpagesën e muajit dhjetor 2019 dhe që kanë një pagë bruto nën masën 100 000 (njëqind mijë) lekë/muaj.*

8. *Dhënie ndihme financiare prej 16 000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) lekësh për aplikuesit e ndihmës ekonomike, të cilët rezultojnë aplikues që nga muaji korrik 2019 e deri në muajin prill 2020, të cilët nuk kanë përfitur ndihmë ekonomike dhe, aktualisht, nuk përfitojnë as nga fondi 6 për qind akorduar bashkë, përveç rasteve që janë përjashtuar nga skema e ndihmës ekonomike, sipas nenit 15, të ligjit nr.57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”.*

II. KRITERET DHE DOKUMENTACIONI PËR PËRFITIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR TË PUNËSUARIT AKTUALË DHE ATA TË LARGUAR NGA PUNA SI PASOJË E COVID-19

1. Ndhimja financiare llogaritet dhe jepet për të punësuarit që figurojnë në listëpagesat e përditësuar sipas formularit ESig-027, deri në datën e hyrjes në fuqi të urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

2. Aplikimi për të përfituar ndihmë financiare bëhet nga subjekti i të punësuarit.

Në rastet e mosaplikimit nga ana e subjektit, ndihma financiare për të punësuarit apo ish-të punësuarit do të jepet menjëherë pas miratimit nga administrata tatimore. Miratimi kryhet pas verifikimit të kriterëve bazuar në të dhënat që administrata tatimore disponon apo të dhënave që të punësuarit apo ish-të punësuarit do të dorëzojnë.

Të dhënat që do të dorëzohen janë të njëjta me ato të parashikuara në pikën 6, të këtij kreu. Afati për dorëzimin e këtyre të dhënave është deri në datën 5 qershor 2020.

3. Punonjësi që është në më tepër se një listëpagesë përfiton si ndihmë financiare vetëm një pagesë.

4. Punonjësit të cilët përfitojnë sipas vendimit nr.254, datë 27.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masën e përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 000 000 lekë, ndihmës ekonomike dhe të pagesës të të ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore të shpallur si pasojë e COVID-19”, nuk janë subjekt i këtij vendimi.

5. Për të përfituar nga ndihma financiare duhet që punonjësi të ketë qenë në marrëdhënie pune, sipas përcaktimeve në kreu I, të këtij vendimi.

6. Subjektet aplikuese duhet të paraqesin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, nëpërmjet portalit e-filinig, kërkesën me të dhënat e përfituesve, ku përfshihen:

a) të dhënat identifikuese të subjektit tatimpagues të pajisur me NIUS;

b) të dhënat identifikuese të përfituesve, përfshirë:

i. emrin, mbiemrin, numrin e telefonit, adresën e-mail-it;

ii. numrin personal të identifikimit të përfituesit;

iii. bankën ku përfituesi ka llogarinë rrjedhëse bankare;

iv. IBAN-in e llogarisë bankare.

7. Nuk përfitojnë ndihmë financiare, sipas këtij vendimi,:

a) individët e punësuar, të cilët kanë realizuar për vitin 2019 të ardhura bruto nga paga mbi 2 000 000 (dy milionë) lekë;

b) individët e dypunësuar, ku njëri prej aktiviteteve bën pjesë në kategorinë e aktiviteteve të përmendura në shkronjën “b”, të pikës 4, të kreut I, të këtij vendimi;

c) punonjësit e institucioneve shtetërore si dhe të punësuarit në shoqëritë me kapital shtetëror;

ç) organizatat jofitimprurëse.

III. PROCEDURA E VERIFIKIMIT PËR PËRFITIMIN E NDIHMËS FINANCIARE

1. Administrata tatimore, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e aplikimit, verifikon në sistemin tatimor, identifikon aplikuesit dhe të dhënat në kërkesën e tyre, duke analizuar:

a) tatimpaguesin dhe veprimtarinë e tij, për të verifikuar nëse bën pjesë në listën e veprimtarive që përfitojnë ndihmën financiare;

b) krahasimisht listën e paraqitur për përfitim ndihme me listëpagesën e dorëzuar në mënyrë elektronike;

c) të ardhurat e realizuara nga subjekti.

2. Me qëllim shmangien e abuzimit, strukturat e administratës tatimore, duke përdorur analizën e riskut, mund të kryejnë edhe verifikime në subjektet aplikuese nëse përmbushen kriteret.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve i paraqet Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit listën përmbledhëse të individëve përfitues të ndihmës financiare, me të dhënat e mëposhtme:

a) Emrin, mbiemrin, numrin e telefonit, adresën e-mail-it;

b) Numrin personal të identifikimit të përfituesit;

c) Bankën ku përfituesi ka llogarinë rrjedhëse bankare;

ç) IBAN-in e llogarisë bankare.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit kryen pagesat për individët përfitues, sipas këtij vendimi.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ruan dhe administron dokumentacionin e përcaktuar sipas këtij vendimi, sipas dispozitave ligjore e nënligjore të parashikuara për ruajtjen e dokumentacionit dhe arkivat.

6. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve miraton rregullat procedurale për zbatimin e këtij vendimi, bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse, procedurat e kalimit në thesar të ndihmës financiare dhe njoftimin e subjekteve, *si dhe rregullat dhe hapat proceduralë që do të ndiqen për zbatimin e paragrafit të dytë, të pikës 2, të kreut II.*

7. *Drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dërgojnë listat e familjeve, të cilat nuk janë përzgjedhur përfituese të skemës së ndihmës ekonomike pranë bashkive, për të njoftuar familjet dhe për të kryer pagesat për ndihmën financiare.*

IV. MASA E NDIHMËS FINANCIARE

1. Ndihma financiare, që përfiton i punësuar aktual apo ai i larguar nga puna, përcaktohet në pikat 1, 2, 3 dhe 5, të kreut I, të këtij vendimi.

2. Ndihma financiare, për të punësuarit, në shumën e përcaktuar në pikat 1, 2, 3 dhe 5, të kreut I, të këtij vendimi, mbulon periudhën prill – qershor 2020 dhe përfitohet vetëm një herë si shumë e vetme.

Të punësuarit apo të ish-punësuarit, të cilët përfitojnë ndihmën financiare sipas këtij vendimi, përjashtohen nga përfitimi njëkohësisht nga paketat e mbështetjes shtetërore të pagesës së ndihmës ekonomike si dhe të pagesës të së ardhurës nga papunësia, mbështetur në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, sipas të cilit nuk lejohet përfitimi në të njëjtën kohë nga dy skema të mbështetjes shtetërore.

Për të gjithë aplikuesit për pagesë papunësie, të cilët kanë plotësuar dosjen brenda kriterëve ligjore dhe kanë fituar statusin e përfituesit të pagesës së papunësisë, nuk humbet e drejta për përfitim të pagesës së papunësisë, por lërvimi i pagesës së papunësisë do të fillojë pas mbarimit të skemës sipas këtij vendimi, nëse do të jenë ende të papunë.

3. Verifikimi, llogaritja dhe shpërndarja për përfituesit sipas pikave 1, 2, 3 dhe 5, të kreut I, të këtij vendimi, do të bëhet sipas procedurave të dokumentimit e të shpërndarjes nga institucionet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

V. Çështje të fundit

1. *Efektet financiare, në masën 7 269 200 000 (shtatë miliardë e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë milionë e dyqind mijë) lekë, do të përballohen nga zëri “Kontingenca për paketën sociale anti-COVID”, miratuar në buxhetin e shtetit, për vitin 2020.*

2. *Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.*

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama